

VENDIM
Nr.60, datë 21.1.2009

**PËR REALIZIMIN SHËRBIMIT FINANCIAR TË LETËRKREDISË, NË FAVOR TË
OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES, NË PROCESIN E PRIVATIZIMIT
TË TIJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbim financiar, në kuptim të këtij vendimi, është letërkredia, e nxjerrë nga banka, agjente për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, si pjesë e transaksionit financiar të marrëveshjes së garancisë pjesore të riskut, që do të lidhet ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Botërore për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD).

2. Procedura e realizimit të këtij shërbimi financiar do të bëhet në baza konkurruese, sipas vlerësimit të kryer nga Ministria e Financave dhe të pranuar nga Banka Botërore.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për përgatitjen e listës së bankave, që do të marrin pjesë në këtë konkurrim, dhe të kërkesës për propozim, për realizimin e këtij procesi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha